



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "ARTMOTION" SH.P.K.  
Numri i biznesit - 71364887  
Person i autorizuar – Valon SHALA  
OSHMA "BEAT"  
Rr/Lidhja e Pejës, Zona Industriale  
Prishtinë

Ref:1802/147/LIC/ni

## VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale "BEAT" për transmetim  
përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

---

### Faktet


1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 15 janar 2018, kandidati "BEAT", ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.

### Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA "BEAT", në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.
5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së "BEAT" ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve medilae audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së "BEAT", duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati "BEAT" ka përmbushur kriteret kualifikuese për t'u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

#### Vendim

8. Komisioni merr vendim që, kandidatit "BEAT", me seli në Prihstinë, t'i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



26.02.2018

datë